



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:258855

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05482863

P.nr.289/2021

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore ne Pejë – Dega ne Klinë, Departamenti i përgjithshëm penal, me Gjyqtaren Sabrije Rraci dhe me pjesëmarrjen e zyrtaren ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër te pandehurit Rr (S) G nga fsh S, K. K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupore nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPPK –së, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë themelore në Pejë me numër PP/II.nr.287/21 te datës 05.11.2021 në seancën e majtur me dt. 19.03.2024 në prezencë të prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, e të pandehurit Rr. G të autorizuarit të tij av.Valdet Zeqiri, te dëmtuarit F.K, mbrojtësit te dëmtuarit, av Zef Marleku, dhe të dëshmitareve E.R, D.T dhe V.D me datë 21.03.2024 merr këtë :

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

I pandehuri R. G, i lindur ... ne fsh S, K. K, ndërsa tani me banim ne fsh D, K.K i biri i S dhe nenës H e vajzërisë K, i martuar baba i 4 fëmijëve, me profesion si policë, pranë sektorit te hetimeve ne stacionin policorë ne Klinë, me numër te kartelës, me numër personal, i nacionaliteti shqiptar shtetas i republikës se Kosovës gjendet ne liri.

REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

Më dt., rreth orës ne K....., pikërisht ne Stacionin Policor ne Klinë, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit F. K, në atë mënyrë që, ditën kritike (gjersa i pandehuri ishte ne detyrë zyrtare, e kishte sjellë në stacionin policor të dëmtuarin dhe pasi që i dëmtuari kishte kërkuar nga i pandehuri të ja jap telefonin, i

pandehuri refuzon, dhe ne ato momente i dëmtuari tenton që të largohet nga stacioni policor, arrin të dera e hyrjes, ku aty i pandehuri e pengon të njëjtin që të largohet duke e kapur nga prapa) pastaj i pandehuri e godet të dëmtuarin me grushta dhe shqelma, me ç' rast të njëjtit i shkakton lëndime trupore,

- me çka kishte për të kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 362, par.1, të KPPRK-së, për të akuzuarit e lartcekur merr këtë:

AKTGJYKIM REFUZUES

- I. REFUZOHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë me numër PP/II nr. 287/2021 e dt. 05.11.2021 për të akuzuarin R(S) G nga fsh S, K. K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupore nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPPK-së.
- II. Prokurori i shtetit ne mungesë të provave ne fjalën përfundimtare ka hjek dorë nga ndjekja penale.
- III. UDHËZOHET i dëmtuari F.K nga fsh. Zh .K. M që kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në Klinë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshme, ka ngritur Aktakuzën, PP/II.nr. 287/2021 e dt. 05.11.2021 kundër të pandehurit, R (S) G nga fsh S, K. K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupore nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPPK -së.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Klinë me datë 30.01.2024, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencë të prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurit

Rr.G, ku i pandehuri është deklaruar se nuk e pranon fajësinë, heq dore nga shqyrtimi i dyte dhe te kalohet direkt ne shqyrtime gjyqësorë.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor kryesor me date 19.03.2024 ne prezencën të pandehurit Rr. G, mbrojtësit te tij av Valdet Zeqiri, palës se dëmtuar F. K mbrojtësit te tij av Zef Marleku dhe administrimit të të gjitha provave po te njëjtën date prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare, ka hjek dorë nga ndjekja penale duke deklaruar pas procedimit te provave personalë dhe materiale gjate seancës se këtij shqyrtimi gjyqësore nuk u vërtetua me asnjë prove se këtu i pandehuri Rr. G, ka kryer veprën penale Lëndim i lehte truporë neni 185 para1 nen par 1.4 te KRPK-se si qeshte përshkuar ne disipozitivin i te aktakuze dhe për këtë arsyeje tërhiqem nga aktakuza. Objekt i këtij shqyrtimi gjyqësore, nga dëgjimi i dëshmitareve ne seancën e datës 26.02.2024 te zyrtareve policore E. Rr dhe D. T qe kane qene ne detyre, nga momenti i ndalimit dhe shqiptimit te gjobës për kundërvajtje këtu te dëmtuarit e deri ne shoqërimin e tij ne stacionin policorë dhe ne dhomën e intervestimit si të përbashkët ne deklaratën e tyre kane mohuar faktin se këtu i pandehuri ta ket sulmuar ta ket goditur këtu te dëmtuarin si qeshte përshkuar ne aktakuze edhe pse kane vërtetuar faktin se gjate tere kohës këtu i dëmtuari ka bere rezistencë aktive duke kundërshtuar shoqërimin dhe arrestimin e tij ne stacion policore dhe ndaj te njëjtit është përdorur forca me qellim te vetëm te vënies se tij ne kontroll, edhe pse i dëmtuari menjëherë është dërguar për tretman mjekësor për shkak tre ankesave te tij ne QKM ne Kline sipas raportit te mjekut te dt12.03.2020 me numër te protokollit 875 tek i dëmtuari nuk është kontestuese qe janë konstatuar lëndime truporë ne pjesën regjionit te qafës, skuqe e duarve ne pjesën e vendosjes se prangave qe vërteton faktin se i njëjti ka rezistuar shoqërimin dhe arrestimin e tij në polici, kështu qe edhe lëndimet e konstatuara te eksperti mjekoligjore te dt. 13.01.2021 janë si pasoje e rezistencës se tij aktive shoqërimit dhe arrestimit te tij. Nga provat materiale te këtij shqyrtimi gjyqësore si qeshte raporti nga komisioni për shqyrtim dhe përdorim te forcës fizike te dt. 24.09.2021 është konstatuar forca fizike ndaj tij ka qene ne pajtim te administrativ 02/21 për përdorim te forcës dhe kjo është bere ne pajtim me rregullat Policisë s e Kosovës, nga shikimi i CD pjesë e shkresave te datës 19.03.2024 në prezentë këtu te dëmtuarit, mbrojtësit te tij, dhe palëve te tjera në procedurë vërtetohet

fakti se nga momenti i hyrjes ne stacionin policore e deri ne shoqërimin te tij ne dhomën e intervistimit pjesën dërmuese e shoqërimin te tij behet nga zyrtari policore E. Rr përveç pjesëve te dera hyrjes se objektit ku shihen përleshje dhe kjo ne funksion te vënies se tij nen kontroll, po ashtu nga transkriptet e IKP te nxjerra ne baze te incizimeve te dërgua nga këtu i dëmtuari Fitim Krasniqi ne IKP vërtetohet, fakti se nga momenti i ndalimin dhe deri ne momentin e shoqërimin te tij ne polici pjesën dërmuese te tij janë me zyrtarin policore E. Rr dhe vetëm ne dy pjese vërehet komunikim këtu me të pandehurin Rr.G, dhe ne ketë bisede ne mes tyre nuk vërehet asgjë si fyese, kërcënuese ne drejtim këtu te dëmtuarit, e qe është ne pajtim te plote edhe me deklaratat e zyrtareve tjetre policore. Se zyrtari policore i kyqyr në rast ka qene zyrtari policore E.R, edhe pse nuk është kontestuese ne baze te raportit mjekësor te IML te dt. 13.01.2021, tek i dëmtuari janë konstatuar lëndime t lehta trupore, duke marr parasysh faktin rezistencën aktive te tij gjate shoqërimin dhe arrestimit te tij dhe përdorimin e forcës për vurjen e tij ne kontroll, përfaqësuesi i akuze pretendon se këto lëndime janë shkaktuar si pasoje e resitenzces se tij aktive shoqërimin dhe arrestimit te tij, andaj duke marre parasysh provat materiale dhe personalë te lartcekura te cilat asnjë mënyre te drejtpërdrejtë as ne mënyrë te tërthorte nuk e inkriminojnë këtu te pandehurin Rr. G, se i njëjti te ketë kryer veprën penale nga neni 185 par 1 dhe për arsye te lartcekura tërhiqem nga aktakuza.

Vendimi i gjykatës

Me qenë se Prokurori i Shtetit pas nxjerrjes se provave , ka hjek dore nga ndjekja penale kundër te akuzuarit, gjykata ne kuptim te nenit 362 par. 1 pika 1.1 te KPPK-së, e ka refuzuar aktakuzën dhe ka vendos si ne dispozitiv te aktgjykimit.

Andaj duke u bazuar në dispozita ligjore te neni 362 par 1 pika 1 përcaktohet: gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata, duke u bazuar në të lartëcekurat gjykata muar aktvendim refuzues.

Konform dispozitave ligjore të nenit 453, par.1, të KPPRK-së, u vendos që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të buxhetit të gjykatës për arsye se Prokurori i shtetit hoqi dorë nga akuza ndaj të pandehurit.

Andaj nga arsyet e theksuara më lartë konform dispozitave ligjore të nenit 25, par.2, 26, par.2, dhe 362, par.1 të KPPRK -së u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË

P.nr. 289/2021 me datë: 21.03.2024

Zyrtare ligjore
Liridona Palushi

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 8 ditësh, nga data e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.